

## PYJET E KOSOVËS JANË TË DEFINUARA SI PASURI KOMBËTARE.

Shfrytëzimi i Pyjeve të Kosovës është e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligjin shtetëror për Pyje.

Legjislacioni Pyjor rregullon planifikimin, mbrojtjen, silvikulturën, shfrytëzimin e produkteve drunore dhe jo drunore, pronësinë, tjetërsimin dhe përdorimin e pyjeve dhe tokave pyjore, përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve pyjore, financimin publik, hulumtimet pyjore, mbikëqyrjen dhe çështje të tjera.



# NDALË SHKATËRRIMIN E PYJEVE

## Ruaj Sot që ti Gezojnë Nesër

Kosova ka krijuar institucionet që mund të administrojnë pyjet në mënyrë të qëndrueshme.

Agjencia Pyjore e Kosovës është organi kryesor përgjegjës për operacionet pyjore në gjithë Kosovën.

### RAPORTO TË GJITHA AKTIVITETET ILEGALE PYJORE, NË APK DHE NË POLICINË E KOSOVËS



PYJET janë  
burim i **JETËS**

# PYJET SI PASURI KOMBËTARE





# Pyjet si Pasuri Kombëtare

Pyjet janë eko-sistemet më produktive, më komplekse dhe më të rëndësishme në natyrë.

- Pyjet janë një nga prodhuesit më të mëdhenj të oksigjenit;
- Pyjet janë absorbues të dyoksidit të karbonit;
- Pyjet janë furnizuesit më të mëdhej të lagështisë në atmosferë (menjëherë pas deteve dhe oqeanëve)
- Pyjet janë rregullues të burimeve dhe sistemit ujor në tokë...

Pothuajse gjysma e territorit të Kosovës është e mbuluar me Pyje.

Përveç rolit për të mbajtur ekuilibrin ekologjik, pyjet e Kosovës janë gjithashtu edhe furnizuesit e rregullt dhe më besnik të lëndës drunore (drurit si lëndë djegëse dhe drurit teknik), frutave të ndryshme malore dhe bimëve mjekësore. Eko-sistemet pyjore kanë role të shumfishta për qeniet njerëzore dhe mjedisin në përgjithësi.

Funksionet e pyjeve janë tri – dimensionale: Mjedisor- Social - Ekonomik

Në aspektin mjedisor, pyjet janë të pakrahasueshme me ekosistemet e tjera në natyrë.



Në aspektin social, pyjet luajnë një rol të rëndësishëm për furnizim me produkte dhe shërbime të ndryshme, si: material druri dhe produkte drunore, bimë ushqyese, bimë medicinale, vendbanim për faunën e egër, punësim, rekreacion, peizazh, etj.



Në aspektin ekonomik, pyjet ofrojnë punësim dhe aktivitete të cilat sjellin të përfitime dhe të ardhura për shtetin



Për të siguruar të gjitha këto funksione, Pyjet në Kosovë duhet të shfrytëzohen në përputhje me kriteret e njohura ndërkombëtarisht për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve:

- Mirëmbajtje dhe zgjerim adekuat i burimeve pyjore, dhe ndikimi tyre në ciklin global të karbonit
- Mirëmbajtja e shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemeve pyjore.
- Mirëmbajtja dhe nxitja e funksioneve produktive të pyjeve ( drunore dhe jo–drunore);
- Mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi adekuat i diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore
- Mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi adekuat i funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos të ujit dhe të Tokës);
- Mirëmbajtja e funksioneve dhekushteve tjera socio – ekonomike.



\* Pothuajse gjysma e territorit të Kosovës është e mbuluar me Pyje